



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; [kqz.sekretariati@kqz-ks.org](mailto:kqz.sekretariati@kqz-ks.org); [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org)

## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Nr. 13

Datë: 28. 02. 2020. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Çemalij Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Ylli Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyese: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.11 dhe 12 /2020;

**2. Aktivitetet e ZRPP-së;**

- Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të grupei te pare te vëzhguesve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës;
- Shqyrtim dhe miratimi i Udhëzuesit për hedhjen e Shortit dhe Renditjen në Fletëvotim të Subjekteve Politike për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës;

**3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

**4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacionet Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i udhëzuesit për procedurat e pranim-dorëzimit të materialeve zgjedhore në ditën e zgjedhjeve, nga Këshillat e vendvotimit tek Komisioni Komunal Zgjedhor;

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjilan.;

- **Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Tingullit, Llogos, Sloganit dhe Dizajnit, për fushatën e informimit publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës;

**5. Shqyrtimi dhe miratimi komisionit për mbikëqyrjen e prodhimit (shtypjes) të fletëvotimeve për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës;**

**6. Të ndryshme.**

---

**1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.11 dhe 12 /2020*

**Valdete Daka:** Përshëndetje të gjithëve, e hapi mbledhjen e 13 -të të KQZ-së. A ka dikush vërejtje në këtë rend dite ? Nëse jo, kush është për këtë miratim të rendit të ditës. Vazhdojmë me miratimit të procesverbait të mbledhjeve 11 dhe 12. A ka dikush vërejtje në këto procesverbale ? Nëse jo, kush është për miratimin e këtyre procesverbaleve ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këto dy procesverbale.

**2.Aktivitetet e ZRPP-së**

**1.Shqyrtim dhe miratimi i rekomandimit për akreditim të grupi të parë të vëzhguesve për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës**

**YII Buleshkaj:** Faleminderit shumë e nderuara kryetare. Ashtu si i keni para jush, ne s'i zyre kemi dy pika në agjend: E para, shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimin e vëzhguesve. Kemi pranuar aplikimin e njërit nga mediave vendore, i cila i ka përgaditur të gjitha dokumentet ashtu siç kërkohet. Ka aplikuar fillimisht me 6 vëzhgues, sepse tek ne edhe mediat akreditohen për ta përcjellur secilën punë që ndërlidhet me aktivitetet zgjedhore. Bëhet fjalë për median Arbnesh.info, dhe ka 6 vëzhgues. Zyra, e ka shikuar dokumentacionin, nuk ka gjetur dicka që mos të bëhet akreditimi, dhe rekomandojmë para jush për t'i aprvuar.

**Valdete Daka:** Kush, është për akreditimin e këtyre gjashtë vëzhgesve...?

Anëtarët e KQZ-së, miatuan grupin prej gjashtë (6) vëzhguesve.

2. Shayrtim dhe miratimi i Udhëzuesit për hedhjen e Shortit dhe Renditjen në Fletëvotim të Subjekteve Politike për zgjedhjet jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës

**YII Buleshkaj:** Siç e dimë, kemi tre kandidat nga tri parti politike që kanë aplikuar për kryetar për komunën e Podujevës. Është koha që ata të térheqin numrin e tyre, ashtu që të jenë të radhitur në fletvotim. Është kërkesë ligjore që para çdo térheqje, aprovohet udhzuesi që do e shfrytëzoj ekipi që organizon ngjarjen e hedhjes së shortit është i ngjashëm me herët e kaluara, térheqja bëhet nga një zyrtar nga sekretariati i cili e térheq emrin e subjektit politik që është një top i futur që nuk ka shenjë ku del përfaqshuesi i subjektit politik. Kurse në shportën tjetër, térhiqet numri me të cilën do të jenë të radhitur në fletvotim numrat, 10,11,12... Si zakonisht, ligji parashev që kryetarja të jetë udhëheqse e kësaj ngjarje kurse zëdhënësi e bënë moderimin e aktivitetit. Kjo parashihet të mbahet të hënën në orën 11.

Anëtarët e KQZ-së, miatuan udhëzuesin për hedhjen e shortit dhe Renditjen në Fletëvotim të Subjekteve Politike për Zgjedhjet Jashtëzakonshëm për Kryetar në Komunën e Podujevës

**3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

**YII Buleshkaj:** Para jush po e paraqes vetëm një përbledhje të shkurt të aktiviteteve që janë zbatuar deri sot ky raportim do të jetë verbal si përbledhje janë diku 42 aktivitete që janë realizuar plotësisht nga plani i aktiviteteve në proces jami në 12 dhe nuk janë realizuar janë 7 që kryesisht janë vonuar për shkak të vonesës së aprovimit të buxhetit kontraktimi i operatorit nuk është realizuar për ti zbatuar këto aktivitete. Janë dy raste kur ka pasur vonesë një ose dy në realizime njëra ka qenë që me rikrutim kemi shkuar në një proces tjetër dhe trajnimi duhet të ndodh më vonë pas rikrutimit disa nga aktivitetet duhet të përmenden si: ka përfunduar periudha e certifikimit të subjekteve politike të hënën bëhet térheqja për 3 subjekte politike, ëshë rekrutuar stafi jo përmanent rreth 70 përmes konkursit të hapur që ka qenë kërkes e auditorit, periudha për shërbim votues që ka filluar më 17 shkurt përfundon. Sot votuesit aplikojnë për ndrimin e qendrës së votimit deri sot kanë aplikuar 140 persona më shum se gjysma kanë ardhur në format online pjesa tjetër me letër e kanë dorzuar aplikacionin tek zyrtari në Podujevë, procesi i konfirmimit dhe kundërshtimit të listës votuese.

Lista, është publike në zyret e zyrtarve komunal të Kkz ku dikush mund të shkoj dhe të kontrolloj nëse dikush që nuk diuhet është në list pastaj janë procedura të gjykatave prë ta larguar nga lista apo për ta shtuar nuk ka informat për këtë periudhë, ne kemi realizuar trajnimin e trajnerëve të gjith trajnerët për Podujevë janë trajnuar nga niveli qendror. Kemi pranuar ekstraktin e parë të listës së votuesve sot pritet të pranojm edhe ekstraktin e dytë i pari ka pasur 86860 votues, mbrenda afatit deri më 23 shkurt kemi pranuar 234 aplikacione për tu regjistruar për të votuar përmes postës 227 janë

aprovar dhe 7 janë refuzuar për shkak të mungesës së dokumentacionit, jami në ditët e fundit ku votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta mund të regjistrohen për të pranuar shërbimin për votim përmes ekipeve mobile deri më 1 mars është afati.

Ne, tha Buleshkaj, ju bëjm thirrje partive politike që janë certifikuar të gjithë ojq-qve mediave për të vëzghuar zgjedhejt që të aplikojnë për akreditim të gjith ata që janë të gatshëm ti dorzojnë aplikaconet e tyre në zyrën për regjistrim të partive politike, si përfundim desha të flasë për aktivitetet e prokurimit deri tani i kemi nënshkruar 4 kontrata një kotrat nënshkruhet sot një aktivitet i prokurorimit është anuluar për shkak se operatori ka dështuar me sjell çertifikatën që nuk i ka borgj Atk-së 4 janë në proces të ofertimit 7 të tjerat janë në proces të përgaditjes së dosjeve këtë janë nën shumën 1000€.

#### **4.Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

##### **1. Këshilli për Operacionet Zgjedhore**

Shqyrtimi dhe miratimi i udhëzuesit për procedurat e pranim-dorëzimit të materialeve zgjedhore në ditën e zgjedhjeve, nga Këshillat e vendvotimit tek Komisioni Komunal Zgjedhor:

**Alim Rama:** Falemniderit, ky këshill ka pasur takim të mbajtur me 26 shkurt, dhe ka shqyrtuar udhzuesin për procedurat e pranim dorzimit të materialeve zgjedhore në ditën e zgjedhjeve: nga këshillat e vendvotimit, deri te komisioni komunal zgjedhore. Materiali nuk është këtu, por ne në këshill e kemi trajtuar, dokumenti është sipas rregullave, dhe është gati i njejtë si në zgjedhjet e kaluara...

**Sami Hamiti:** Materiali, do të ishte mir të ishte këtu realisht. Alimi e ka kërkuar të vendoset në KQZ të obligohen në parim sekretariatin, le të dihet që një udhëzues është bërë dhe duhet të veprojmë pérndryshe, udhzuesi është i saktë sipas ligjit, formalisht votohet në KQZ... Megjithatë, duhet të dihet kush është përgjegjës nëse dicka dështon, pra mbahet llogari...

**Eshref Vishi:** Mendoj se, unë kam pak rezervë për miratimin e këtij udhzuesi për procedurat e pranim dorzimit materialit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve nga KKZ, në KVV apo, ansjelltas. Mendoj se kemi edhe akte tjera që e rregullojnë këtë cështje, duke i përmendë dy rregullore: rregulloren 18/2016 për KKZ, dhe rregulloren 19/2016 për këshillat e vendvotimit që e rregullojnë të njejin material, përfshirë këtu edhe doracakun e procedrave të votimit. Mendoj se procedurat duhet të thjeshtohen dhe tu mundsohet antarëve të KKZ dhe të KVV-së që të keni qasje më të shpejt në organizimin e procesit zgjedhor por po dyshoj se, dublifikimi i këtyre materialeve më shumë e komplikon se sa që e lehtëson këtë. Faktikisht, anëtari i KVV e ka doracakun me veti ku në doracak janë të përcaktuara të gjitha proceduart e përsëritura në udhëzues: nga pranimi i materialeve, deri te paketimi dhe dorzimi i materialit në KKZ...

**Yll Buleshkaj:** Më vjen keq që nuk është printuar në email u është dërguar materiali është praktik e mir që gjithçka të jetë në një vend në vend se zyrtari të kërkoj tri dokumente. Kjo është praktikë e mirë që është ndjekur gjithmon, është si dokument që mund ta kenë si udhëzues gjatë procesit se informata, është e vërtetë, më lehtë procesohet, dhe u lehtsohet punën zyrtarve që merren me pranim-dorzim.

**Sami Hamiti:** Është e vërtet se është shqyrtuar udhëzuesi, dhe e kemi parë është shumë mirë që ekziston ky udhëzues sepse, problemet më të mëdha ndodhin sepse matrialet në fund s'po dijnë t'i bartin ose, mbetet libri jashtë ose, diqka tjetër...! Tash ishin tejet shumë mirë të sqaruar, dhe është i nevojshëm të jetë ky doracak...

**Yll Buleshkaj:** Në asnjë prej doracakëve, nuk ceken përmirsimet që duhet të bëhen është mir të ceket ngjyra herën e kaluar kemi pasur keqkuptime që është ndërhyrë në formular është mir të aprovohet të bëhet dokument zyrtar në zgjedhjet e kaluara është menduar se askush, nuk mund të shkruaj në formular të rezultateve përvëç në vendvotime.

**Valdete Daka:** Në fakt, ne kemi pasur probleme të jashtëzakonshme për shkak të këtyre detajeve të cilat kanë shkaktu kokqamje pas ditës së zgjedhjeve pasi është dashur edhe ta anulojm edhe të rinumrojmë për çështje teknike nuk është asgjë keq nëse është një dokument i cili i përfshinë të gjitha nuk jemi duke bërë jashtë rregullativës ligjore edhe i kanë më kuartë dhe më precise nuk kanë nevojë ti lypin në udhëzuesin e gjatë. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-ë, miratuan udhëzuesin për procedurat e Pranim-Dorëzimit të materialeve zgjedhore në ditën e zgjedhjeve nga Këshillat e Vendvotimit, tek Komisioni Komunal Zgjedhor

## **2.Këshilli për Çështje Ligjore**

*Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjilan:*

**Arianit Elshani:** Këshilli për çështje ligjore e ka shqyrtuar kérkesën për zëvendsimin e këshilltares komunale në Gjilan, dhe me shumicë votash ka rekomanduar ta aprovojnë në KQZ me që kanë kaluar të gjithë filtrat ligjor dhe komunal zgjedhor dhe departamentit ligjor.

**Valdete Daka:** Faleminderit, kush është për që znj. Aferdita Balaj - Ajdini të emrohet antare e Kuvendit Komunal në Gjilan nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtaren e kuvendit komunal, znj. Antigona Kqiku.

Anëtarët e KQZ-së, unanimisht miratuan këtë zëvendësim.

### **3.Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik:**

**1.Shqyrtimi dhe miratimi i Tingullit, Llogos, Sloganit dhe Dizajnit, për fushatën e informimit publik për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës**

**Arianit Elshani:** Faleminderit kryetare gjatë ditës së djeshme kemi mbajtur edhe mbledhjen e khillit për informim publik ku kemi shqyrtuar pikat që janë të paraqitura në rend të ditës: tingullin, llogen dhe sloganin. Tingullin, mbase na prezanton edhe operatori i cili, është prezent këtu nga tre tinguj që janë propozuar ne kemi vendosur që të shkojm me tinguj që, është përdorë në zgjedhjet e fundit parlamentare për arsyet versioneve që kanë ardhë ndoshta, është mirë t'i prezentojmë...

Në këtë pikë, diskutuan: Alim Rama, i cili ka propozuar që KQZ ta ta standardizoj një tingull të zgjedhjeve, cilat do qofshin dhe të mos ketë nevojë për ndryshim në cdo palë zgjedhje, Valdete Daka, e cila po ashtu, ka qenë në favor të këtij propozimi etj., pastaj Sami Hamiti

Në fund, anëtarët e KQZ-së miratuan Tingullin, Llogen, Sloganin dhe Dizajnin

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i Komisionit për Mbikqyrjen e Fletvotimeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune të 15 marsit, 2019 në Komunën e Podujevës**

Në këtë pikë, debatuan Valdete Daka, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ylli Buleshkaj. Në fund, u tha se shtypjen e fletëvotimeve e mbikqyrë një zyrtar i Sekretariatit, dhe se nuk ka nevojë për ndonjë vendim...

**Valdete Daka:** Atëherë, tjetër nuk kemi...! Térheqja e shortit bëhet të hënën, në ora 11: 00